

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - shërbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Sigurimi i jetës dhe shëndetit për punonjësit e OST sh.a.”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

66511000-5 – Shërbimevtë sigurimit e jetës.

VLERA E FONDIT LIMIT:

14,228,650 (katërmëdhjetë milion e dyqind e njëzet e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor “**Operatori i Sistemit te Transmetimit**” (OST) sh.a. ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, te paktën 14,000,000 (katërmbëdhjetë milion) Leke.

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura dhe kopje të certifikuara të bilanceve ku të paktën në dy bilance të fundit, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasine e mallrave dhe punimet objekt procedure prokurimi, kerkohet qe OE ofertues te paraqese se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare per ta realizuar ate ne kohe dhe ne perputhje me specifikimet teknike te kerkuara. Per kete, OE ofertues duhet te kete disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me kete qellim, eshte argumentuar se vlere e xhiros duhet te jete ne masen 14,000,000 (katërmbëdhjetë milion) Leke.

2.3.1 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete realizuar gjate tri viteve te fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kontrata te ngjashme ne nje vlere te pakten prej 5,000,000 (pese milion) Lekë pa TVSH.

Lidhur me kete pike:

Kur OE ka realizuar kontrata me nje ent publik, kerkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlere, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën,

prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën afërisht 35 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë specifikimet dhe cilësinë e shërbimit objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë me kontrata të ngjashme, të jetë afërisht 35 % të vlerës të fondit, afër vlerës maksimale të lejuar. Në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues ka eksperiencën dhe mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikojnë në ecurinë e punës së AK.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues, në përputhje me Ligjin Nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, duhet të jetë i licencuar nga AMF (Autoriteti i Mbrojtjes Financiare) për ushtrimin e veprimtarisë në klasën 1 – Sigurimi i Aksidenteve, klasën 2 – Sigurimi i Sëmundjeve dhe/ose klasa 19 - Sigurimi i jetës. Për të përmbushur këtë kriter, OE ofertues duhet të paraqesë licencën me kategoritë përkatëse.

Argumentimi: Ky kriter është në përputhje me objektin e procedurës së prokurimit. Licencimi i OE ofertues për të ofruar shërbimin objekt kontrate është në zbatim të Ligjit Nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, sipas kategorive përkatëse për të cilat do të realizohet kontrata. Ky kriter është vendosur mbështetur në nenin 41/4/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe Nenin 77, pika 2, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një vetedeklarim, ku të specifikojë se merr përsipër dhe pranon, si më poshtë vijon:

- a) Kompania e sigurimit të jetës e licensuar nga AMF për ushtrimin e veprimtarisë në klasën 1 – Sigurimi i Aksidenteve, klasën 2 – Sigurimi i Sëmundjeve dhe/ose klasa 19 -Sigurimi i jetës.*
- b) Të ofrojë mbulimin për shërbimin spitalor, me garanci pagese (pa paguar i siguruari)*
- c) Të paraqesë metodën që aplikon çdo i siguruar për gjurmimin e kërkesave për rimbursim në mënyrë që personi i siguruar të ketë transparencë të procesit të rimbursimit*
- d) Të paraqesë procedurën e organizimit të shërbimit pa pagesë kur shërbimi mjekësor merret jashtë Shqipërisë;*
- e) Të paraqesë procedurën e rimbursimit të shërbimit kur shërbimi mjekësor merret jashtë Shqipërisë;*
- f) Në rast emergjence të siguruarit nuk duhet të refuzohet shërbimi në rrjetin mjekësor të Siguruesit, me paraqitjen e kartës së sigurimit. Në rast jo emergjente shërbimi me garanci pagese nga Siguruesi ofrohet pasi është dakorduar midis të siguruarit dhe siguruesit.*

Argumentimi: Ky kriter vendoset për të dhënë sigurinë AK që OE ofertues të ketë përgjegjësitë përkatëse për sigurimin e jetës dhe shëndetit për punonjësit, sipas përshkrimit të Termave të Referencës objekt procedure prokurimi. OE ofertues duhet të ketë të qartë se do të marrë përsipër riskun në rastin e evidentimit të nevojës që punonjësit e AK të kenë nevojë për mbulim spitalor apo shëndetësor, sipas përshkrimeve në Termat e Referencës dhe Dokumentet e Tenderit.

2.3.4 *Ne funksion te plotesimit te Shtojces 9 "Formulari permbledhes i vetedeklarimit" Operatori Ekonomik ofertues duhet te jape te dhena te qarta si Emer, Mbiemer, Atesi, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje te skanuar te dokumentit te identifikimit (shqiptar ose te huaj), per Administratorin/Administratoret e shoqerise, Ortakun/Ortaket e shoqerise, perfaqesues te ndryshem te posacem te shoqerise, drejtues te ndryshem te shoqerise.*

Argumentimi: Ky kriter është hartuar dhe vendosur referuar Njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76/1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", Autoriteti Kontraktor OST sh.a. ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Për këtë arsye, verifikimi i këtyre personave kërkon të dhëna të sakta si emër, mbiemër, atësi, amësi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personit. Ky kriter plotësohet me anë vetëdeklarimi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike jane hartuar duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, per sherbimet objekt procedure prokurimi, duke perlllogaritur sasite e nevojshme te sherbimeve, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve te nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik".